



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Lulzim Bajrami</b>	<b>03.01.2024</b>	<b>03.01.2024</b>	<b>2023/1057</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.12.2023, OE “Sfinga SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1057, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Grup i Operatorëve Ekonomik PLUS TRADE L.L.C.; VIZIONLEDD GROUP SH.P.K.”- Prishtinë: “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit” me nr. të prokurimit: "656-23-11775-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, furnizim, vlere e parashikuar e kontratës: xx,xxx €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**Neni 1 i LPP-së - Qëllimi Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 108\_A i LPP-se.**

Njoftimi lidhur me Vedimin e AK Komuna e Ferizajt e kemi pranuar me dt. 08.12.2023 me te cilin u njohtuar se jemi shpallur tenderues i pasukseseshme. Kerkuam qasje dhe ajo na u lejua.

Për GOE kemi konstatuar disa mangësi .

1. GOE e rekomanduar per kontrate nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” 9.1 & 9.2

## Kapaciteti teknik dhe professional

9.1 & 9.2

### Kapaciteti teknik dhe professional

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë

### Dëshmia e kërkuar dokumente

1. Lista e kontratave nënshkruar dhe e vulosur nga operatorët ekonomik apo i operatorëve ekonomik të ofroj listën e kontratave realizuara gjatë tri viteve fundit nga data e njoftimit për kontratë të këtij tenderi origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca apo raporte teknike të shërbimeve të cilat tërësisht përmbushin kriteret të vlerësimit. Kur punë kryer për ndonjë kontratë private duhet të ofrohet dëshmia nga banka për referencat.

Shumë qartë në FDT specifikohet : “Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë” Lideri i grupit nuk përmbush 60% të vlerësimit minimale .

Të vetmen kontratë dhe referencë me shërbime të ngjashme të realizuar e ka me KK Kacanik në vlerë 17799,55 euro.

2. Edhe Partneri në GOE të rekomanduar me kontratë nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional Ka ofruar një listë ku nuk specifikohen as datat , as vlerat e kontratave të realizuara sic kërkohet në FDT . Poashtu nuk është nënshkruar dhe vulosur nga Partneri i GOE

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Sfinga SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit” me numër të prokurimit: “656-23-11775-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ

Projekti 2023	
Nr	Emri projektit
1	Katrati Petrol 208*160 Led Display D.A
2	Katrati Petrol 256*160 Led Display Dy ansh
3	Petrol Kompan (Dragodan) 160x256 1 ansh
4	Petrol Kompan (Gagllavic ) 192x288 1 ansh
5	Petrol Kompan(BRESJE) 192x288 2 ansh
6	Hib Petrol (Vushtri) 384x256 led display2 Anshe
7	Hib Petrol (Vushtri) 8x6 Billboard
8	Hib petrol Ferizaj 4 Led display Dy anshe
10	Hib petrol Gjilan 384x256 L.D. DV ANSHE
12	Hib petrol Podujeve 384x256 L.D. DV ANSHE
13	Hib petrol Ferizaj 1 160x256 L.D. DV ANSHE
14	Hib petrol Feriza2 288x192 L.D. DV ANSHE
15	Hib petrol Feriza3 256x64 x256x576 L.D. DV ANSHE
17	De ferizaj 384x576 nje anshe
18	De Prishtin 0.80x224x0.80 nje anshe
19	Devoli Logostik Tv Display
20	Burger King

Te vetmen kontrate te paraqitur nga Partneri i GOE i rekomanduar per kontrate eshte ajo me HIB Petrol Corporation SHPK e cila mban datën 26.10.2023 .

---

**KONTRATË PËR FURNIZIMIN E MALLRAVE DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDËRLIDHURA**  
(Për HIB Ferizaj 4)

---

Nr.Prot. HPC.10/2023

E lidhur në Prishtinë, më datën 26.10.2023, në mes të palëve kontraktuese:

- VIZIONLEDD GROUP SH.P.K.** me numër unik identifikues **811419482**, me seli në Rr. Tirana, Prizren, përfaqësuar nga znj. Qëndresa Januzaj, Drejtor. (Këtu e tutje referuar si “VIZIONLEDD” ose “Shitësi”);  
dhe
- HIB Petrol Corporation SH.P.K.**, me numër unik identifikues **812030493**, me seli në Magj. Ferizaj – Prishtinë, Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, përfaqësuar sipas Autorizimit LRP.Nr.21222/2023 nga z. Etrit Ademaj. (Këtu e tutje referuar si “HIB Petrol Corporation” ose “Blerësi”).

*DUKE QENË SE Shitësi bën një ofertë dhe përfaqësim të përvokueshëm për furnizimin e mallrave sipas specifikave të blerësit dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me to dhe përfaqëson dhe garanton se mund të përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga Kontrata;*  
*DUKE QENË SE Blerësi bën një përfaqësim të përvokueshëm për të blerë mallra dhe shërbime të ndërlidhura me to dhe përfaqëson dhe garanton se mund të përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga Kontrata;*

Kjo kontrate e dt. 26.10.2023 eshte dite e njejte me datën e publikimit te Njoftimit per Kontrate te këtij aktiviteti 26.10.2023 dhe nuk mund mirret per baze per kete aktivitet

Njoftim - B05 Njoftim per Kontrat	
Hape:	<a href="#">Ueb faqja</a> <a href="#">Dokument PDF</a>
Blerësi	KOMUNA FERIZAJ
Kodi/Numri	2023/656-23-11775-1-2-1/B05-0029174
Emërtimi	Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit
Lloji i dokumentit*	B05 Njoftim per Kontrat
Lloji i kontratës	1 Furnizim
FPP	29000000-9 Makineri, pajisje, aparate dhe produkte te shoqëruara
Lloji i procedurës	1 Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar	76,148.36
Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje	15.11.2023 13:00
Data e njoftimit	26.10.2023
Data e dërgimit	25.10.2023
Ligji	LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVES
Dorëzimi elektronik i ofertave	Po

Me dt.18.12.2023 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se sa i perket kerkeses per rishqyrtim ku e ka rrefuzuar me arsyetimin si e pa bazuar. AK-ja ne arsyetimin e saj nuk ka dhene asnje pergjigje konkrete si dhe asnje arsyetim te bazuar se vendimi i saj paraprak ka qen i drejt dhe ne pajtushmeri me dispozitat ligjore te LPP-se.

Gjithashtu AK-ja ne munges te fakteve nuk ka dhene asnje sqarim ne asnje nga pretendimet tona ankimore, ku kemi deshmuar me fakte se OE i rekomanduar per kontrate nuk e i ploteson kerkesat e FDT-se dhe dosjes se tenderit.

Ne ne kerkesen per rishqyrtim kemi konsatuar dhe kemi argumentuar se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ploteson kerkesen tek Kapaciteti teknik dhe profesional pikat 9.1 dhe 9.2 ku eshte kerkuar qe OE ekonomik te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses sherbime te ngjashme ne 3 vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate) ne vlere minimale 110,000.00 eurove.

OE i rekomadnuar per kontratat shumicen e deshmive qe i ka prezantuar jane punime elektrike dhe ndriqim publik, por qe nuk kane lidhje me titullin e kontrates qe eshte “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit”, dhe nuk jane as kontrata te natyres se ngjashme. Duke u bazuar ne titullin e kontrates qe eshte i qart qe kerkon pune me “Monitor Digjital” eshte e qart se OE i rekomanduar per kontratat nuk ka deshmi qe ka punuar pune te natyres se ngjashme, pra me furnizim, montim e vendosje te monitoreve digjital.

Ne edhe ne kerkesen per rishqyrtim e kemi sqaruar ne detaje dhe me fakte konkrete se OE i rekomanduar per kontrate nuk e permbush kerkesen e lartcekur, mirpo AK-ja qellimshem po i anashkalon faktete dhe pa dhen asnje sqarim e ka feruzuar kerkesen per rishqyrtim. Se AK-ja refuzimin e kerkeses per rishqyrtim duhet ta arsyetoj dhe ta argumentoj vendimin e saj, e te

cilen e parasheh edhe Neni 108\_A i LPP-se, perkatesisht paragrafi 9 ku thot: “Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimet e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, andaj të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, pasi që pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë janë të qëndrueshme sepse i njëjti është i papërgjegjshëm. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burime ve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa AK-ja në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

**VENDIM APROVOHET ankesa e OE “SFINGA” SH.P.K. si e bazuar,**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së, si dhe lënda te kthehet në **RIVLERËSIM,**

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p><b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b></p> <p><b>Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë</b></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><b>1.Lista e kontratave (e nenshkuar vulosur), operatori ekonomik apo g operatoreve ekonomik duhet te ofroj kontratave te realizuara gjate tri vi fundit nga data e njoftimit per kont ketij tenderi ne original, te nenshkru vulosur nga OE, te deshmuar me ref apo raporte te pranimeve tekni shërbimeve te cilat tregojne daten.Kur pune eshte kryer per kompani private duhet te ofrohet dëshmia nga banka per ato referencia.</b></p>
---	-----------	---	--

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

## DEKLARATË

Komisioni vlerësues, për dhënie të kontratës, rekomandon; Gr.i OE: "Plus trade" L.L.C. dhe "Vizion led d group" SH është ofertues i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët të ofruar.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Sfinga SH.P.K.

**Pretendimi Ankimor nr.1:** GOE te rekomanduar me kontrate nuk permbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, ku është kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b> <b>Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë</b>	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b> <b>1.Lista e kontratave (e nenshkruar vulosur), operatori ekonomik apo g operatorëve ekonomik duhet te ofroj l kontratave te realizuara gjate tri vi fundit nga data e njoftimit per kont ketij tenderi ne origjinal, te nenshkru vulosur nga OE, te deshmuar me ref apo raporte te pranimeve tekni shërbimeve te cilat tregojne daten.Kur pune eshte kryer per kompani private duhet te ofrohet deshmia nga banka per ato referencia</b>
---	-----------	--	--

### **Përgjegjia e ekspertit shqyrtues:**

Eksperti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.*

*Operatororert ekonomik ofertues kan dorzuar ofertën si grup dhe te nejtit kan marrveshje te bashkëpunimit konform Nenit 71 te LPP dhe Dosjes se tenderti pikës 11.1.*

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të:

1. **PLUS TRADE L.L.C.** me Numër unik identifikues 811451864, e përfaqësuar nga z. Përparim Dalloshi, Drejtor .
2. **“ VIZIONLEDD GROUP SHPK „** me numër unik identifikues UNI: 811419482 e përfaqësuar nga znj. Qëndresa Januzaj, Drejtor .

Lënda e marrëveshjes së Bashkëpunimit të kompanive të sipërpërmendura është për tenderin:

Titulli: **Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit 656-23-11775-1-2-1**

Të cilat më tutje do të quhen si Anëtarë të Konzorciumit, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

### Neni 1

Anëtarët e konzorciumit (Grupi i operatorëve Ekonomik) është i njëzëshëm për themelimin e konzorciumit **PLUS TRADE L.L.C & VIZIONLEDD GROUP SHPK „** në tekstin e mëtejme “KONZORCIUMI” dhe do të ofrojnë ofertën përmes bartësit të konzorciumit për tenderin e shpallur nga **KOMUNA FERIZAJ.**

Titulli: **Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit 656-23-11775-1-2-1**

Emri i konzorciumit: **PLUS TRADE L.L.C.” & „VIZIONLEDD GROUP SHPK „**

### Neni 2

Palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri udhëheqës **PLUS TRADE L.L.C. & i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën.**

### Lider i grupit sipas marrveshjes se bashkëpunimit mes operatoreve ekonomik është OE „PLUS TRADE L.L.C”

Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet te ketë dëshmi për përfundimin e projekteve te ngjajshem ne këto koncept ne cilesin e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës kam hasur ne disa projekte te përfunduara nga ana e OE, liderit te grupit „PLUS TRADE L.L.C” dhe te cilat ne cilesin e eksperti konstatoj se janë te ngjajshme me konceprin eprokurimit, koncepti dhe qellimi i prokurimit ka te bëj me qështje te instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka

dorzuar dëshmit si ne vijim e te cilat janë te ngjajshme me natyren e prokurimit:

### **Kontratat dhe dëshmit e prezantuara nga lideri i grupit „PLUS TRADE L.L.C"**

Rregullimi i ndriqimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit **104,647.50 euro**

Vendosja e ndriqimit publik ne territorin e Komunës se Fushë Kosovës, Vlera e projektit **47,382.00 euro**

Rregullimi i ndriqimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit **73,555.00 euro**

Totali i projekteve te ngjajshme te prezantuara nga lideri i grupit është - **225,584.50 euro**

### **Kontratat dhe dëshmit e prezantuara nga anetari i grupit „VIZIONLEDD GROUP SHPK „**

Kontrata me HIB PETROL e dëshmuar edhe me Fatura për TV DISPLAYIT ne vleren prej, **16,300 euro**



23-PSV01-001-19

"VIZIONLEDD GROUP" SH.P.K

NRF: 811419482

Nrb: 811419482

Tvsh: 330449208

RR. TIRANA P.N - PRIZREN / KOSOVE

Tel: +38349300724

Email: vizionled@gmail.com

www.vizionled.com

Bleresi:

**HIB Petrol Corporation SH.P.K.**

Adresa: Talinoc i Muhaxherëve, Magjistratja Ferizaj -  
Prishtinë, p.n Ferizaj Ferizaj

Telefoni: +38338777777

No fiskal: 812030493

Numri unik: 812030493

No TVSH: 330553819

Data	Kushtet	Validiteti	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
25.10.2023		25.10.2023			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njesia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	1292	TV DISPLAY P5 OUTDOOR	1.00	Copë	13,813.56	0.00	18.00	16,300.00	16,300.00

HIB PETROL - FERIZAJ 4. Nga dita e konfirmimit, parapagim 70% ne fillim te punimeve, ndersa 30% ne perfundim te punimeve.

Vlera pa TVSH : 13,813.56


Rabati : 0.00


TVSH : 2,486.44

Vlera per pagese: **16,300.00 EUR**

**FATURA për kryerjen e furnizimeve me LED DISPLAY për Armotin SHPK ne vleren prej 15,000 euro**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Sfinga SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit” me numër të prokurimit: “656-23-11775-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ





20-SHV01-001-130

---

"VIZIONLEDD GROUP" SH.P.K

NRF: 811419482      Nrb: 811419482      Tvsh: 330449208

RR. TIRANA P.N - PRIZREN / KOSOVE

Tel: +38349300724      Email: vizionled@gmail.com      www.vizionled.com

**Bleresi:**

**ARTMOTION SH.P.K.**

Adresa: LIDHJA E PEJES,ZONA INDUSTRIALE

No fiskal: 810200866

Data fatura	Kushtet	Data e skadimit	User	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
08.12.2020		08.12.2020	Admin			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njesia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	105	LED DISPLAY	1.00	Copë	12,711.86	0.00	18.00	15,000.00	15,000.00
		<b>Normat Tatimore</b>	<b>Baza</b>	<b>TVSH</b>	<b>Vlera</b>				
		TVSH e llogaritur 0%	0.00	0.00	0.00	Vlera para zbritjes: 12,711.86			
		TVSH e llogaritur 8%	0.00	0.00	0.00	Rabati : 0.00			
		TVSH e llogaritur 18%	12,711.86	2,288.14	15,000.00	Vlera pa TVSH : 12,711.86			
						TVSH : 2,288.14			
						<b>Vlera per pagese: 15,000.00 EUR</b>			
						Pagesa: 0.00			
						Mbetja: 15,000.00			

Anetari i grupi te konzorciumit **VIZIONLEDD GROUP SHPK** ka ofruar si dëshmi edhe disa fatura te këtyre natyrave.

Duke pasur parasysh këto ne cilesin e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është **PLUS TRADE L.L.C** ka prezantuar Kontrata, dhe referencia te ngjajshme ne vleren prej **225,584.50 euro** dhe i njeti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kerkeses se dosjes se tenderit, po ashtu anetari tjetër i grupit **VIZIONLEDD GROUP SHPK**, ka prezantuar disa Fatura dhe kontrata te natyrave te ngjajshme dhe konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për dhënie ploteson këtë kriter e referencave te ngjajshme te keruara dhe pretednimi ankimo është i pa bazuar.

Vlen te thekësojm se kriteri i dosjes se tenderti ka qenë çmimi me i lirë i përgjegjshëm dhe se operatorit ekonomik i rekomanduar ka çmimin me te lire te ofertës se vleresuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të

LPP- së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh shqyrtimin e pretendimit ankimor dhe dokumentacioneve te ofruara ne ofert nga ana e Gr.te operatoreve ekonomik te rekomanduar, konstatoj se pretendimi ankimor eshte i pa bazuar dhe kerkoj nga ana e PSH.OSHP qe te refuzoj ankesen e operatorit ekonomik si te pa bazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sfinga SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit**” me numër të prokurimit: “**656-23-11775-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Sfinga SH.P.K.**

**Lulzim Bajrami**

